

# Kushtet treguese të HIV-it:

## Udhëzime për implementimin e analizave të HIV-it tek të rriturit në ambientet e kujdesit shëndetësor

### Përmbledhje

Nga rreth 2,3 milion individët e infektuar me HIV që jetojnë në rajonin e Evropës, është llogaritur se një në tre nuk ka dijeni për gjendjen e tij të HIV-it, duke çuar në nivele të mëdha të diagnostikimeve në fazë të vonuar dhe transmetimeve të mëdha në rajon. Në Evropën Perëndimore, diagnostikohen dhe futen në kujdesin shëndetësor të vonuar 45-50% e individëve të sapodiagnostikuar me HIV (p.sh. me numër CD4 <350 qeliza/ $\mu$ L). Diagnostikimi i vonuar lidhet me rritjen e sëmundshmërive dhe vdekshmërive që lidhen me HIV-in, reagimin më të dobët ndaj trajtimit, rritjen e kostove në kujdesin shëndetësor dhe rritjen e përqindjeve të transmetimit. Prandaj, ka shumë dobi të diagnostikimit në fazë të hershme, dhe kjo është arsyeja pse diagnostikimi i hershëm duhet të jetë strategji kyçe në shëndetin publik. Diagnostikimi i hershëm kërkon qasje inovative për të përmirësuar analizat mes atyre që ka më shumë të ngjarë të infektohen me HIV dhe që paraqiten vonë për kujdes shëndetësor.

Ky udhëzues fokusohet te individët që shkojnë në institucione kujdesi shëndetësor, të tilla si specialitete mjekësore ku analizat për HIV mund të mos bëhen si pjesë e kujdesit mjekësor standard për pacientët e veçantë me probleme mjekësore të caktuara. Kjo qasje e re e propozuar, analiza për HIV e drejtuar nga kushtet treguese, duhet të jetë element shtesë i një strategjie kombëtare të përgjithshme të analizave për HIV. Ky udhëzues është zhvilluar nga një panel me përfaqësues nga një sërë shoqatash klinike të specializuara evropiane me informacione intelektuale nga Zyra Rajonale e OBSH-së për Evropën dhe Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve. Audiencia e synuar e udhëzuesit janë të gjithë ofruesit e kujdesit shëndetësor në specialitetet dhe ambientet përkatëse si edhe personeli përgjegjës për mbikëqyrjen e programeve të analizave për HIV. Ky udhëzues është ndërtuar pjesërisht mbi metodologjinë e zhvilluar përmes studimit HIDES (HIV Indicator Diseases Across Europe Study), i cili dokumentoi kushtet treguese me më shumë se 0,1% prevalencë të HIV-it të pazbuluar. Studimet e fundit tregojnë realizueshmërinë dhe pranueshmërinë e futjes të analizave për HIV të drejtuara nga kushtet treguese të HIV-it si pjesë e kujdesit të zakonshëm, por gjithashtu ekzaminon vështirësitë në implementimin e tij të cilat kërkon të adresojë ky udhëzues.

### Objektivat e këtij udhëzuesi janë që:

- Të nxitë dhe mbështetë përfshirjen e analizave për HIV të drejtuara nga kushtet treguese në strategjitë kombëtare për analizimin e HIV-it, duke marrë parasysh prevalencën lokale të HIV-it, programet e vazhdueshme të analizimit dhe ambientin lokal të kujdesit shëndetësor;

- Qasjet e rekomanduara dhe mjetet praktike për edukimin dhe trajnimin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor për kapërcimin e pengesave për rekomandimin e një analize për HIV.

### Kushtet treguese të HIV-it mund të ndahen në 3 kategori:

1. Kushtet që përcaktojnë AIDS mes PLHIV;
2. Kushtet që lidhen me një prevalencë të HIV-it të padiagnostikuar prej >0.1%;
3. Kushtet ku mosidentifikimi i pranisë të infeksionit HIV mund të ketë implikime negative të mëdha për kontrollin klinik të individit.

Ka një numër të madh provash nga eksperimentet e kontrolluara në formë rastësore për pasojat e mostrajimit të njerëzve që jetojnë me HIV të cilët kanë kushte që përcaktojnë AIDS-in. Mosrekomandimi i një analize në këto rrethana nuk do të konsiderohej praktikë klinike e mirë. Analizimi i rregullt për kushtet me prevalencë të HIV-it prej  $\geq 0.1\%$  është raportuar se është kosto-efektiv dhe se ka mundësinë të rritë diagnostikimin e hershëm të HIV-it dhe të çojë kështu në mundësi më të hershme për kujdes dhe trajtim mjekësor.

### Rekomandimet:

- Çdo person (i cili nuk dihet tashmë se është pozitiv me HIV) që tregon se ka **kushte që përcaktojnë AIDS** duhet të **rekomandohet rreptësisht për analiza për HIV**.
- Çdo person që ka një **kusht me një prevalencë të HIV-it të padiagnostikuar prej >0.1%** duhet të **rekomandohet rreptësisht për analiza për HIV**.
- Për kushtet treguese ku **opinionit ekspert konsideron prevalencën e HIV-it të jetë me shumë mundësi >0.1%**, por në pritje të provave të mëtejshme, rekomandohet që të **ofrohen analizat**.
- Për kushtet ku **mosdallimi i pranisë të infeksionit të HIV-it mund të ketë implikime të konsiderueshme negative** për kontrollin klinik të individit, **duhet të ofrohen analizat** për të shmangur shtypjen e mëtejshme të sistemit imunitar me rezultate të mundshme negative serioze për individin, dhe për të rritur në maksimum reagimin e mundshëm ndaj trajtimit të kushtit tregues (pavarësisht nëse prevalenca e llogaritur është më pak se 0,1% apo jo).

Dokumenti i plotë udhëzues është i disponueshëm në anglisht në [www.hiveurope.eu](http://www.hiveurope.eu)

Tabela 1: Përkufizimet e kushteve treguese dhe rekomandimeve për analiza për HIV

1. Kushtet të cilat janë përcaktuese të AIDS mes PLHIV\*

Rekomando analizat rreptësisht:	<p><b>Neoplasma:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kancer i qafës të mitrës</li> <li>• Limfoma jo-Hodgkin</li> <li>• Sarkoma Kaposi</li> </ul> <p><b>Infeksionet bakteriale</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mycobacterium Tuberculosis, pulmonare ose ekstrapulmonare</li> <li>• Mycobacterium avium komplekse (MAC) ose Mycobacterium kansasii, i përhapur ose ekstrapulmonar</li> <li>• Mycobacterium, specie të tjera ose specie të pidentifikuara, i përhapur ose ekstrapulmonar</li> <li>• Pneumoni, e përsëritur (2 ose më shumë episode brenda 12 mujash)</li> <li>• Salmonella septicaemia, e përsëritur</li> </ul> <p><b>Infeksionet virale</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Cytomegalovirus retinitis</li> <li>• Cytomegalovirus, tjetër (përveç mëlçisë, shpretkës, gjendrave)</li> <li>• Herpes simplex, ulçerë(a) &gt; 1 muaj/bronkit/pneumonit</li> <li>• Leukoencefalopati multifokale progresive</li> </ul> <p><b>Infeksione parazitare</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Toksoplazmozë cerebrale</li> <li>• Diarre kriptosporidiozë, &gt; 1 muaj</li> <li>• Isosporiazë, &gt; 1 muaj</li> <li>• Leishmaniazë e përhapur atipike</li> <li>• Riaktivizim i tripanosomiazës amerikane (meningoencefalit ose miokardit)</li> </ul> <p><b>Infeksione fungale</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pneumoni pneumocystis carinii</li> <li>• Kandidiazë, oesofageale</li> <li>• Kandidiazë, bronkiale/ trakeale/ mushkëri</li> <li>• Kriptokokozë, ekstra-pulmonare</li> <li>• Histoplazmozë, e përhapur/ ekstra-pulmonare</li> <li>• Kokidiodomikozë, e përhapur/ ekstra-pulmonare</li> <li>• Penicilizoë, e përhapur</li> </ul>
---------------------------------	--

3. Kushtet ku mosidentifikimi i pranisë të infeksionit HIV mund të ketë implikime negative të mëdha për kontrollin klinik të individit.

Ofro analizat:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kushtet që kërkojnë terapi agresive imuno-supresive:             <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kancer</li> <li>• Transplant</li> </ul> </li> <li>• Sëmundje auto-immune të trajtuara me terapi immunosupresive</li> <li>• Hapësirë primare që zë dëmtim në tru.</li> <li>• Purpura trombocitopenike idiopatike/trombotike</li> </ul>
----------------	--

2a. Kushtet që lidhen me një prevalencë të HIV-it të padiagnostikuar prej ≥0.1%

Rekomando analizat rreptësisht:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Infeksione të transmetueshme seksualisht</li> <li>• Limfomë malinje</li> <li>• Kancer anal/displasi</li> <li>• Displasi e qafës të mitrës</li> <li>• Herpes zoster</li> <li>• Hepatit B ose C (akut ose kronik)</li> <li>• Limfadenopati e pashpjeguar</li> <li>• Sëmundje ngjashëm mononukleozës</li> <li>• Pneumoni e marrë në komunitet</li> <li>• Leukocitopeni/trombocitopeni e pashpjeguar që zgjat &gt;4 javë</li> <li>• Dermatit/ekzantemë seborrhike</li> <li>• Sëmundje pneumokoke invazive</li> <li>• Temperaturë e pashpjeguar</li> <li>• Kandidaemia</li> <li>• Leishmaniasis e organeve të brendshme</li> <li>• Shtatzëni (implikime për fëmijën e palindur ende)</li> </ul>
---------------------------------	---

2b. Kushte të tjera që konsiderohen se mund të kenë një përhpaje të HIV-it të padiagnostikuar prej > 0.1%

Ofro analizat:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kancer primar i mushkërive</li> <li>• Meningit limfocitik</li> <li>• Leukoplaki orale me qime</li> <li>• Psoriasis atipike ose e rëndë</li> <li>• Sindroma Guillain-Barré</li> <li>• Mononeurit</li> <li>• Dementia nënkortikale</li> <li>• Sëmundje ngjashëm sklerozës të shumëfishtë</li> <li>• Neuropati periferike</li> <li>• Rënie në peshë e pashpjeguar</li> <li>• Kandidiazë orale e pashpjeguar</li> <li>• Diarre kronike e pashpjeguar</li> <li>• Dëmtim kronik i veshkave i pashpjeguar</li> <li>• Hepatit A</li> <li>• Kandidiazë</li> </ul>
----------------	---

\* Bazuar në sistemin e klasifikimit të QKS dhe OBSH